



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	553
Data/Gabim.	14.07.2020
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	

Në bazë të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068 ,
UA Nr.10 / 2018 dhe në bazë të nenit 8, paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, lidhur me
kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës , Drejtori i Drejtorisë për Arsim
në Fushë Kosovë shpallë:

K O N K U R S për këto vende të lira

1. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Selman Riza “ – Fushë Kosovë**
 - Një (1) arsimtar klasor në kohë të caktuar (pushim lehonie)
2. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Mihal Grameno “ – Fushë Kosovë**
 - Tre (3) arsimtarë klasor , dy prej tyre në kohë të caktuar (pushim lehonie)
 - Tre (3) arsimtarë të TIK-ut në kohë të caktuar (pushim lehonie)
 - Dy (2) arsimtarë të gjuhës shqipe në kohë të caktuar (pushim lehonie)
3. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ Daut Bogujevci “ Fushë Kosovë**
 - Një (1) arsimtar klasor në kohë të caktuar (pushim lehonie)
4. **Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët “ Zejnel Salihu “ – Bardh i Madh**
 - Një (1) arsimtar të matematikës në PNF- Pomozotin
5. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “Bajram Curri “ Sllatinë e Madhe**
 - Një (1) arsimtar të matematikës në PNF- Henc
 - Një (1) arsimtar klasor në Sllatinë të Madhe
 - Një (1) arsimtar klasor në PNF- Henc
 - Dy (2) arsimtarë klasor në kohë të caktuar në PNF- Harilaç (pushim lehonie)
 - Një (1) punëtor teknik
6. **Shkolla Filllore e Mesme e Ulët “ V.Frashëri “ Miradi e Poshtme**
 - Një (1) arsimtar klasor në PNF- Miradi e Epërme
 - Një (1) arsimtar të gjuhës gjermane me plotësim norme në shkolla tjera
7. **Shkolla e Mesme e Lartë “Hivzi Sulejmani “ Fushë Kosovë**
 - Një (1) arsimtar të psikologjisë
8. **Shkolla e Mesme e Lartë “H.K.Prishtina “ Fushë Kosovë**
 - Një (1) arsimtar të matematikës në kohë të caktuar (pushim lehonie)
 - Një (1) arsimtar të informatikës në kohë të caktuar (pushim lehonie)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për Mësim klasor – programi fillor :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- ☐ Fakulteti i Mësuesisë

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për Gjuhë shqipe :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Gjuhë dhe letërsi shqipe
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për Psikologji :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Psikologji
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për Matematikë :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në Matematikë
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për Gj. gjermane :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – programi: Master Gjuhë dhe letërsi gjermane
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për mësime dhënëse/e për TIK –ut :

- ☐ Fakulteti i Edukimit – Programi Master në TIK
- ☐ Sistemi katërvjeçar;
- ☐ Baçelor (katërvjeçar)

Kriteret e kualifikimit për punëtor teknik :

- ☐ Shkolla e mesme

Dokumentacioni i nevojshëm :

- Të jetë banor i Kosovës - letërnjoftimi
- CV
- Çertifikata e lindjes
- Diploma e fakultetit
- Vertetimi se nuk është nën hetime

Sqarim : Në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët (1 – 5), kandidatët duhet të kenë së paku 240 ECTS, përkatësisht 4 vjet , kurse në ciklin (6 – 9) dhe (10 – 12) duhet të kenë 300 ECTS . Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA-ve të MASHT-it , nuk do të merren në shqyrtim, gjegjësisht , do të refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë .

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:

- Njohuritë e përgjithshme 25 pikë,
- Aftësitë e përgjithshme dhe personalitetit 35 pikë dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe nota mesatare gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diploma të nostrifikuara Ministria .

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për testin me shkrim dhe intervistën me gojë si dhe të gjitha njoftimet tjera publikohen në Faqen Zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës :

<https://kk.rks-gov.net/fushëkosova/> , me tel. apo përmes e-mail-it .

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor shtator, 2020 – gusht, 2021 (komplet viti shkollor).

Në rast të ndonjë nevoje eventuale shtesë për mësimdhënës/e në institucione shkollore, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave prioritare me rastin e shpalljes së rezultateve.

Për shkak të limitimit të buxhetit dhe kufizimit të numrit të normave të punëtorëve , nuk garantojmë sistemimin në lista të pagave .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati i konkursit është 15 ditë prej ditës së shpalljes .

Dokumentacioni komplet dorëzohet në Arkivin e Komunës në katin përdhësë , në ndërtesën e Komunës së Fushë Kosovës .

Adresa : rruga Tahir Zemaj nr.2 - Fushë Kosovë

